



# Llojet endemike të Malit Sharr

Mali Sharr është thesar i paçmueshëm i llojeve të shumta bimore dhe shtazore dhe pikërisht për shkak të biodiversitetit të pasur dhe vlerave të jashtëzakonshme natyrore, ai ka vend të veçantë dhe i njohur në korniza kombëtare dhe ndërkombëtare.



Biodiversiteti përfaqësohet përmes llojeve të regjistruara të shumta bimore dhe shtazore. Në hulumtimin e realizuar në vitet e kaluara, për nevojat e Studimit për vlerësim të Malit Sharr, në pjesën e Republikës së Maqedonisë së Veriut janë regjistruar gjithsej 5502 lloje, e prej tyre madje 220 janë endemike<sup>1</sup>.

Sipas ekspertëve, vlerat natyrore të Malit Sharr imponojnë që mali të shpallet zonë e mbrojtur e kategorisë II përkatësisht park kombëtar për ruajtjen dhe avancimin e vlerave për gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.



<sup>1</sup> Endemit nënkupton lloj ose nënlloj përhapja e të cilave është e kufizuar në zonë të caktuar (Ligji për mbrojtjen e natyrës)